

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Ramë Hyseni dhe Rafet Haxhaj anëtarë, në çështjen juridike të paditësit H.H. nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqëson i autorizuari A.M., avokat nga Gjakova, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës SHA. Divizioni i Rrjetit-Distribucioni Gjakovë, sheshi "...", nr.36, Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari O.K. me autorizim, për kompensim të dëmit, vlera e kontestit 8,822.74 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë, C.nr.426/05 të datës 08.11.2012, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **23.05.2016**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET si e pa themeltë** ankesa e të autorizuarit të paditësit H.H. nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, C.nr.426/05 të datës 08.11.2012, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.426/05 të datës 08.11.2012, kërkesëpadinë e paditësit H.H., nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës SHA. Divizioni i Rrjetit-Distribucioni Gjakovë, që paditësit të lartpërmendur në emër të kompensimit të dëmit t'ia paguaj shumën prej 8,822.74 euro, me kamatën përkatëse ligjore të cilën e paguajnë bankat komerciale në Kosovë dhe e cila fillon të rrjedh nga data 17.12.2002 e tutje, e deri në pagimin definitiv si dhe shpenzimet e shkaktuara procedurale e krejt këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, refuzohet në tërësi si e pa themeltë, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit H.H. nga fsh. ..., Komuna e Gjakovës, kundër të paditurës KEK SH.A Divizioni i rrjetit distributiv Gjakovë, kështu që prishet aktgjykimi i atakuar C.nr.426/05 të datës 08.11.2012, marrë në Gjykatën Komunale Gjakovë dhe çështja i kthehet gjykatës së instancës së parë në rishqyrtim.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

## **-Ankesa është e pa themeltë**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurës me kërkesë për kompensim dëmi. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar duke u bazuar në dispozitat e nenit 319 dhe 322 të LPK-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata është bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për të cilat është thirrur pala në ankesë si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike, në bazë të provave të administruara e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Pretendimi ankimore i palës paditëse se gjykata e shkallës së parë me fajin e saj ka dështuar që të bëjë sigurimin e provave, pasi paditësi në procedurë jashtë kontestimore ka kërkuar që të bëhet sigurimi i provave, është i pa bazuar në tërësi, nga shkresat e lëndës Nd.nr.441/2002, të cilat gjenden si pjesë e kësaj lënde vërtetohet fakti se gjykata ka dal në vendin kontestues, ku është shkaktuar zjarri në prani të ekspertëve B.N. inxh. i ndërtimtarisë dhe T.Z. inxh. i elektros, ka bërë konstatimin e gjendjes faktike, në bazë të cilës gjendje nuk është konstatuar ndonjë lidhje kauzale në mes shkaktimit të zjarrit dhe defekteve në rrjetin energjetik të cilat do të mund të ishin burim i zjarrit në rastin konkret, të cilën lidhje kauzale e mohon edhe raport ekspertiza e datës 12.12.2002, e përpiluar nga T.Z., i cili ka konstatuar se furnizimi i shtallës së djegur është bërë duke u furnizuar me një kabull prej shtëpisë, andaj pretendimi se mbitensioni e ka shkaktuar djegien është i pa qëndrueshëm pasi vetë fakti se nuk është raportuar asnjë dëm tjetër në shtëpinë nga e cila furnizohej me rrymë stalla përjashton mundësinë e mbitensionit.

Po ashtu nga raporti me shkrim nr.01.nr.318/02 datë 25.11.2002, nga Divizioni i Menaxhimit të Emergjencave Gjakovë, nuk përmban ndonjë shënim mbi mënyrën e shkaktimit të zjarrit, në deklaratën e dhënë nga paditësi në cilësinë e të dëmtuarit në Stacionin Policor në Gjakovë me datë 17.11.2002, është deklaruar se arsyen se si ka ardhur deri te zjarri nuk e din por vetëm ka theksuar se ekziston dyshimi se djegia ka mundur të vijë nga një kabull e rrymës, por pa pretendime se atë ditë ka pasur çrregullim në furnizim me energji elektrike.

Pretendimi i palës paditëse se gjykata pa të drejtë nuk ka aprovuar propozimin që paditësi H.H. të dëgjohet në cilësinë e palës, në cilësinë e dëshmitarëve nëna e tij si dhe punëtori i KEK-ut M.B., që është i ngarkuar me mirëmbajtjen dhe inkasimin e shpenzimeve elektrike, si dhe të kërkohet raport nga qendra meteorologjike e KFOR-it, pretendime të cilat Gjykata e

Apelit i vlerëson të pa bazuara, pasi paditësi ka dhënë një deklaratë pas ngjarjes në Stacionin Policor në Gjakovë, ku është deklaruar se nuk din se si ka ndodhur zjarri, andaj çka do të mund të dëshmonte 10 vite pas zjarrit edhe po të dëgjohej, po ashtu sa i përket propozimit që të dëgjohet nëna e paditësit si dhe punëtori i KEK-ut M.B., nuk është dhënë ndonjë arsye bindëse se cilat fakte gjykata do ti vërtetonte përmes dëgjimit të tyre, kërkesa që gjykata ti drejtohet qendrës meteorologjike të KFOR-it nuk ka pasur ndonjë arsyeshmëri, ngase nga raporti i tillë nuk do të provohej ndonjë fakt, pasi kushtet atmosferike nuk kanë mundur të ndikojnë pasi shtalla furnizohej nga shtëpia me kablllo që nënkupton se nuk ekziston përgjegjësi e të paditurës, pasi instalimet brenda rrjetit nga njëtori elektrik është përgjegjësi e pronarit. Fakti se objekti i dëgjur ka qenë i furnizuar nga shtëpia e bënë të pa bazë pretendimin e palës paditëse “se deri te zjarri ka ardhur si pasoje e kushteve të këqija atmosferike, fryme e madhe dhe reshje atmosferike dhe për këtë ka ardhur deri te fërkimi i telave-përçuesve elektrik të cilat kanë shkaku shkëndija dhe është kallë objekti”.

Andaj Gjykata e Apelit vlerëson se refuzimi kërkesëpadisë së palës paditëse në raport me të paditurën ka ardhur si rrjedhojë e gjendjes së vërtetuar faktike në bazë të provave të administruara, si dhe pamundësisë së palës paditëse që me prova të vërtetohet themelësinë e kërkesëpadisë andaj aplikimi i dispozitave të nenit 319 dhe 322 të LPK-së, është i drejtë, për faktin se është obligim i palës e cila pretendon një të drejtë në vërtetimin e themelësisë së saj bazuar në prova konkrete.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 195 pika d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.528/2013, më datë 23.05.2016**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
*Fejzullah Rexhepi*